



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**KOMISIONI I SHËRBIMEVE PUBLIKE**  
(TRANSPORTI, LËVIZSHMËRISË MJEDISORE, PARQEVE, REKREACIONIT,  
IFRASTRUKTURËS DHE STREHIMIT) – 5 ANËTARË

**R A P O R T**

Nr. 3, datë 29. 12. 2025

**“MBI SHQYRTIMIN E PROJEKT-VENDIMEVE TË KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË”**

Me datë **29.12.2025**, ora **10:00**, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Shërbimeve Publike, Transporti, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Infrastrukturës dhe Strehimit.

Procedura e dorëzimit të projekteve dhe relacionet shoqëruese janë në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 22/2018, “Për Strehimin Social” i ndryshuar, VKM nr. 301, datë 25.04.2020, “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banasat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, VKM nr. 362, datë 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 459, datë 03.07.2019, “Rregullat mbi administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzurfuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr. 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe Nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; VKM Nr. 54 datë 05.02.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të menyrës së dhënies me qera, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; si dhe Rregulloren e Këshillit Bashkiak.

Komisioni, në prezencë të Zv. Kryetar e Bashkisë, Znj. Dila Prenga, shqyrtoi projekt - vendimet si më poshtë vijon;

- 1. P/Vendim nr. 6347/1, prot.** i Kryetarit Bashkisë; “Për një ndryshim / shtesë të vendimit nr. 7, datë 24.01.2025, “Për miratimin e pagesës së qirasë, për një periudhë 1 (një) vjeçare sipas vlerës së tregut, për familjet e pastrehë, bashkia Mirditë”, “Përdorim i fondit të mbetur për familjet e tjera në nevojë sipas vlerës së tregut, për familjet e pastrehë ”, Bashkia Mirditë

2. **P/Vendim nr. 6350/1, prot.** i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e dhënies me qera dhe lidhjen e kontratës së re të qerasë mes Bashkisë Mirditë dhe Reçi KGM” Shpk.

## **V E N D O S I:**

- 1) T’i propozojë Këshillit Bashkiak, shqyrtimin e mëtejshëm të projekt-vendimeve të mësipërme.

## **ANËTARËT E KOMISIONIT**

Ndue HALILI - Kryetar, Arben LEKGEGAJ - Zv.kryetar, dhe Aleksandër LUSHA – anëtarë  
&

Aleksandër PICA KU - Kryetar i Këshillit Bashkiak

Konc. raportin në bazë të proces-verbalit të mbledhjes së komisionit;

**Gaspër TOPOLLAJ**

Sekretar i Këshillit Bashkiak

*Bashkëlidhur raportit, foto e takimit të Anëtarëve të Komisionit, Zv.Kryetare e Bashkisë dhe përfaqësues të administrates;*

